

VENDIM
Nr. 128, datë 11.9.2012

PËR PROCEDIMIN ADMINISTRATIV PËR VENDOSJE GJOBE NDAJ SHOQËRISË
“CEZ SHPËRNDARJE” SHA

Në mbështetje të nenit 99 e në vijim të Kodit të Procedurave Administrative, ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neni 64 pika 1 germa “g” dhe “gj” dhe ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.9.2012, pasi shqyrtoi relacionin e grupit të punës bashkëlidhur këtij vendimi, duke konstatuar që “CEZ Shpërndarje” ka shkelur kuadrin ligjor në fuqi:

- ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”;
- vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338 datë 19.3.2008 “Modelin shqiptar të tregut të energjisë elektrike”, të ndryshuar;
- vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 68, datë 23.6.2008 “Rregullat e tregut të energjisë elektrike”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Ndëshkimin me gjobë të “CEZ Shpërndarje” në masën 1 % të të ardhurave vjetore të vitit paraardhës që i korrespondojnë vlerës 430 milionë lekë për mosprokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e të gjitha humbjeve në sistemin e shpërndarjes për vitin 2012.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë “CEZ Shpërndarje” lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani